

BizTECH *Student*

GAZETA STUDENTORE E TIRANA BUSINESS UNIVERSITY

“E ARDHMJA FILLON KËTU”

***Në këtë numër të gazetës
studentore do të lexoni:***

Dita e parë e shkollës - *Tirana
Business University*

Ceremonia e rrjetit të ekselencës

TETORI ROZË NË TBU

Një ditë e zakonshme në jetën e një
studenti të TBU

Taylor Swift:
Kur arti bëhet strategji

*Një Fundjavë Ndryshe në Ndihmë të
Njerëzve në Nevojë*

Studentët e TBU në Epokën e
Inteligjencës Artificiale

Kompania e muajit: MANE TCI
Një histori suksesi shqiptare që
ndërton të ardhmen

Shembuj që frymëzojnë në
universitet

ÇMIMET NOBEL 2025

TEDxTBU: *Innovation* - Mission or
Business?

Diplomimi 2025



Bordi Editorial:

Kryeredaktor: Prof. Asoc. Gerti Sqapi

Redaktore vizuale: Ledja Dushku

Koordinatorë: Bora Bubjaku

Dita e parë e shkollës

Me rrezet e para të diellit të tetorit, kampusi i Tirana Business University u mbush me zëra, buzëqeshje dhe emocione. Pas pushimeve verore, studentët u rikthyen me energji të re, ndërsa të sapoardhurit përjetuan për herë të parë emocionin e hyrjes në një ambient akademik që i pret me ngrohtësi, profesionalizëm dhe shumë mundësi për zhvillim. Në sallën kryesore, ceremonia e hapjes u çel me një mesazh mirëseardhjeje nga Administratori i TBU-së, z. Altin Sholla, i cili theksoi misionin e universitetit:



"Ne jemi një universitet shumë i fokusuar dhe shumë i specializuar në dy drejtime kryesore – zhvillimin e dijeve teorike, por edhe zhvillimin e praktikitetit. Synojmë të krijojmë profesionistë që dinë jo vetëm të mendojnë, por edhe të veprojnë."

Pas tij, Rektorja e TBU-së, Prof. Dr. Vasilika Kume, ndau me studentët një mesazh frymëzues mbi rëndësinë e përkushtimit:

"Me mundim dhe përpjekje arrijmë aty ku kemi synimin. TBU është një hapësirë ku çdo ëndërr merr formë, kur ajo shoqërohet me vullnet, disiplinë dhe bashkëpunim."

Në vijim, Prof. Dr. Elvin Meka, Dekani i Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë, vuri theksin tek zhvillimi i aftësive që tregu i punës kërkon sot:

"Në këtë fakultet, përgatitemi që të kuptojmë jo vetëm teorinë e biznesit, por edhe realitetin e tij. Ju do të mësoni të mendoni si drejtues, si ekonomistë dhe si qytetarë të përgjegjshëm."

Ndërsa Prof. Asoc. Dr. Indrit Baholli, Dekan i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, i inkurajoi studentët të ndjekin pasionin për inovacionin:

"Bota po ndryshon me shpejtësi, dhe ju jeni brezi që do të udhëheqë këtë ndryshim. TBU do t'ju ofrojë mjetet, por për ta ndërtuar të ardhmen duhet të guxoni ju vetë."



Momenti më i ngrohtë i ceremonisë erdhi nga Bora, studente e vitit të dytë, e cila ndau përvojën e saj me emocion:

"Këtu kam mësuar se suksesi nuk matet vetëm me notat, por me mbështetjen, bashkëpunimin dhe kujtimet që ndërtojmë së bashku. Jeta studentore nuk është vetëm libra dhe provime – është rrugëtim, eksperiencë, miqësi dhe zhvillim i aftësive që do t'na shoqërojnë gjithë jetën."



Pas fjalimeve, studentët e rinj patën mundësinë të njiheshin me pedagogët, me ambientet e universitetit dhe me njëri-tjetrin, duke krijuar që në ditën e parë një ndjenjë përkatësie.

Me vizion, pasion dhe përkushtim, TBU vazhdon të jetë vendi ku ëndrrat marrin formë dhe ku çdo student gjen forcën për të ndërtuar të ardhmen e vet.

-Mirë se erdhët në një tjetër vit plot njohuri, sfida dhe suksese – mirë se erdhët në TBU!

-Jonela Grami

"Të nderuar profesorë, drejtues, studentë të rinj dhe miq të TBU, Është një emocion i madh për mua të jem sot këtu dhe të ndaj përvojën time si studente e vitit të dytë.

Kur erdha për herë të parë në TBU vitin e kaluar, nuk e dija se çfarë më priste. Por shumë shpejt kuptova se çdo mundësi që ofron universiteti ishte një hap drejt rritjes time personale dhe profesionale. Që në vitin e parë, u bëra pjesë e çdo aktiviteti: nga Open Sessions, tek CEO Talks, akademitë që TBU ofron për të dyja fakultetet, ku pata mundësinë të mësoj nga profesionistë të nivelit të lartë. Madje dhe lënda ekstrakurrikulare, e cila më ka ndihmuar të jem më shumë sociale. Menjëherë sapo nisa studimet, mora edhe internshipin tim të parë, një eksperiencë që më ndihmoi të kuptoj më mirë lidhjen mes teorisë dhe praktikës. Sot, falë TBU, e gjej veten gjithashtu në një rreth të mrekullueshëm shoqëror, ku suportojmë njëri-tjetrin dhe e shtyjmë të jemi versionin më i mirë i vetes sonë si brenda dhe jashtë shkolle.

Dua të ndalem pak këtu dhe t'i dedikoj disa fjalë shoqërisë sime – njerëzve që e kanë bërë këtë rrugëtim të paharrueshëm. Ju falënderoj për çdo ditë të mbushur me të qeshura, për çdo orë studimi që e kthjem në motivim. Me ju kam mësuar se suksesi nuk matet vetëm me notat, por me mbështetjen, bashkëpunimin dhe kujtimet që ndërtojmë së bashku. Falë jush, çdo sfidë në TBU është bërë më e lehtë, dhe çdo arritje më kuptimplotë. Ju jeni pjesa më e bukur e kësaj aventure.

Një nga eksperiencat më të veçanta për mua ishte të jem moderatore e TedX dhe gjithashtu e TBU Podcast, një hap që më dha mundësinë të zhvilloj aftësitë e mia të komunikimit dhe të ndaj histori frymëzuese me studentë të tjerë. Gjatë gjithë këtij rrugëtimi, TBU më ka dhënë besim, ka vlerësuar çdo dëshirë dhe talent timin, dhe më ka inkurajuar të mos ndalem.

Mesazhi im për ju, studentë të rinj, është ky: bëhuni pjesë e klubeve studentore, merrni pjesë në aktivitete, eksploroni çdo mundësi që TBU ju ofron. Jeta studentore nuk është vetëm libra dhe provime, është rrugëtim, eksperiencë, miqësi dhe zhvillim i aftësive që do t'ju shoqërojnë gjithë jetën.

Sot, kur nisni këtë kapitull të ri, dua t'ju inkurajoj të jeni aktivë, të kërkonit më shumë dhe të shfrytëzoni çdo hapësirë që TBU ju jep. Besoni në veten tuaj dhe mos kini frikë të provoni gjëra të reja, sepse ky universitet do t'ju mbështesë në çdo hap.

Faleminderit dhe suksese të gjithëve në këtë vit të ri akademik!"

– Bora Bubjaku



CEREMONIA E RRJETIT TË EKSELENCËS

2025-2026

Më 25 gusht, Tirana Business University hapi dyert jo për ditën e parë të mësimit, por për një moment edhe më domethënës — "Ceremonia e Rrjetit të Ekselencës TBU 2025-2026."

I zhvilluar në ambientet e universitetit, ky aktivitet mbledhi së bashku rektorin, dekanët, stafin akademik, prindërit, dhe mbi të gjitha, një grup studentësh të spikatur, ku fal perkushtimit të tyre gjatë shkollës së mesme fituan bursën e plotë.



Atmosfera ishte e mbushur me krenari dhe emocion. Një e nga një, perfituesit e bursave u thirrën në skenë për të marrë Certifikatën e Ekselencës, secila prej tyre simbol i viteve të mundit, disiplinës dhe perkushtimit akademik. Për studentët e rinj kjo nuk ishte thjesht një mbështetje financiare — ishte një vlerësim i punës dhe një besim në potencialin që mbartin.

Udhëheqësit e universitetit dhanë mesazhe frymëzuese, ata na kujtuan se të bëhesh pjesë e Rrjetit të Ekselencës TBU do të thotë jo vetëm të festosh arritjet e deritanishme, por edhe të shërbesh si shembull për gjithë komunitetin.

Gjithashtu një prej studenteve, pjesë e rrjetit të ekselencës në vitin e tretë, mbajti një fjalim të shkurtër, ku falë eksperiencës dhe përvojës së saj, theksoi dhe shtyu studentët e rinj të shfrytëzojnë gjithë mundësitë gjithëpërfshirëse që TBU ofron.

Në fund të ceremonisë të gjithë studentët patën mundësinë të njiheshin me njëri tjetrin, dhe kështu TBU konfirmon dhe një herë perkushtimin e tij për të mbështetur gjeneratat e reja, e për të forcuar rrjetin e ekselencës që rritet vit pas viti.

-Irlini Janaqi



TETORI ROZË NË TBU

Në kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, studentet e Tirana Business University, së bashku me Prof. Asoc. Dr. Aurela Braholli, u bashkuan në një aktivitet simbolik duke vendosur fjongo rozë – një gjest që mbart në vetvete forcë, shpresë dhe solidaritet.

Ky muaj na kujton rëndësinë e kontrollit të hershëm dhe parandalimit, por edhe nevojën për të folur hapur mbi shëndetin dhe kujdesin ndaj vetes. Përmes këtij veprimi të thjeshtë, studentët e TBU-së përcollën mesazhin se ndërgjegjësimi nuk ka moshë dhe se kultura e kujdesit duhet të fillojë që herët, që në vitet e para të rritjes dhe studimeve.

Si përfaqësues të brezit të ri, ne kemi përgjegjësinë të përhapim informacionin, të mbështesim gratë që përballen me këtë sëmundje dhe të kontribuojmë në krijimin e një shoqërie më të ndërgjegjshme e të ndjeshme.

Çdo fjongo rozë që vendosim është një kujtesë se çdo hap i vogël mund të bëjë një ndryshim të madh – sepse parandalimi shpëton jetë, dhe shpresa lind nga bashkimi.

– Prof. Asoc. Dr. Aurela Braholli



Një *Fundjavë Ndryshe* në Ndhimë të Njerëzve në Nevojë

Më datë 2 tetor, "Tirana Business University" pati kënaqësinë të kontribuonte në një nismë bamirësie të organizuar në Pallatin e Sporteve "Flamurtari" në Vlorë nga "Mane Foundation" dhe "Fundjavë Ndryshe". Ky bashkëpunim u realizua për të ndihmuar njerëzit me aftësi ndryshe dhe familjet që perballen me vështirësi ekonomike. Përgjatë këtij organizmi u ofruan dyqind karroca për lëvizje, si dhe rroba dhe ndihma ushqimore.

Një ekip prej nëntë studentësh të TBU-së, të udhëhequr nga pedagogu Gerti Sqapi, së bashku shërbyen si vullnetarë në shpërndarjen e ndihmave, në organizimin e logjistikës dhe në komunikimin e ngrohtë me fëmijët dhe familjet që morën mbështetje. Ata paraqitën kujdes të veçantë dhe respekt përgjatë gjithë organizimit të kësaj nisme të mundësuar nga Mane Foundation në bashkëpunim me Fundjavë Ndryshe.

Mirënjohja dhe gëzimi karakterizonte të gjithë procesin e kësaj nisme. Për shumë prej studentëve të TBU-së kjo ishte përvoja e parë e vullnetarizmit- një eksperiencë që mësoi rëndësinë e empatisë, solidaritetit dhe përgjegjësisë sociale.



Për të dyja anët, si stafi organizues dhe familjet në nevojë, u kthyen nga kjo ditë me një ndjenjë të fortë të besimit në shoqëri. Kjo nismë ishte një dëshmi e qartë se ne kemi fuqinë të bashkohemi për të sjellë ndryshime konkrete. Çdo gjest i vogël mirësie ka një vlerë të madhe, por vetëm bashkë kemi fuqinë për të krijuar një shoqëri më të ndjeshme për çdo anëtar të saj.

Ky aktivitet na rikujtoi për misionin tonë shoqëror, por dhe dhuroi një kujtim të veçantë për ne si studentë.

-Tea Hada

Shembuj që frymëzojnë në universitet



Prof. Asoc. Dr. Aurela Braholli: Frymëzim në Botën e Marketingut

Me një karrierë të pasur akademike dhe profesionale, Prof. Asoc. Dr. Aurela Braholli ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në formimin e studentëve në fushën e ekonomisë dhe marketingut. E diplomuar dhe doktoruar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, ajo në vitin 2025 mori titullin Professore e Asociuar, duke kurorëzuar përkushtimin e saj shumëvjeçar në arsim dhe kërkim shkencor. Që prej vitit 2024, ajo ushtron detyrën e Zëvendësdekane e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë në Tirana Business University College, si dhe është lektore dhe koordinatore e programit Master në Marketing Digjital dhe Komunikim. Ajo zhvillon lëndë si Bazat e Marketingut, Menaxhim Marketingu, Sjellje Konsumatore dhe Komunikim Marketingu i Integruar, duke ndërthurur teorinë me praktikën reale të tregut.

Dr. Esmeralda Kadëna: Frymëzim për të rinjtë në teknologji dhe siguri digjitale

Dr. Esmeralda Kadëna është një pedagoge dhe kërkuese e njohur në fushën e teknologjisë dhe sigurisë digjitale. Ajo ka përfunduar doktoraturën në Universitetin Óbuda në Hungari. Aktualisht, ajo është Drejtuese e Departamentit të Inxhinierisë së Software në Tirana Business University College (TBU) dhe ka kontribuar me dhjetëra publikime ndërkombëtare mbi sigurinë mobile, inteligjencën artificiale, blockchain dhe 5G. Përkushtimi dhe pasioni i saj për kërkimin shkencor e bëjnë Dr. Kadënën një model frymëzues për studentët dhe profesionistët e rinj në teknologji.



Xhezmije Palushi MSc. Pasion dhe Përkushtim në Teknologji

Xhezmije Palushi MSc. ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, duke marrë diplomën Master Shkencor në Informatikë në vitin 2013 dhe aktualisht ndjek doktoraturën në fushën e Natural Language Processing. Ajo ka një karrierë të pasur akademike dhe profesionale, duke mbuluar fusha si programimi Java, algoritmikë, inteligjencë artificiale dhe zhvillim software, si dhe eksperiencë si Product Owner në projekte dixhitale. MSc Palushi ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe ka kontribuar në përmirësimin e programeve të studimit në inxhinierinë software. Ajo punon aktualisht si pedagoge full-time në Tirana Business University, ku thekson rëndësinë e pasionit, përkushtimit dhe mësimi praktik për studentët e saj.

TEDxTBU INNOVATION: MISSION OR BUSINESS?

Në një atmosferë plot energji, ide dhe frymëzim, Universiteti Tirana Business University (TBU) organizoi eventin më të rëndësishëm të vitit akademik — TEDxTBU 2025, me temën "Innovation: Mission or Business?".

Kjo ngjarje e veçantë solli në një skenë të vetme figura të njohura nga fusha të ndryshme si biznesi, teknologjia, arti, arkitektura dhe mjekësia, duke u kthyer në një forum të hapur idesh dhe përvoja që frymëzoi studentët dhe publikun.



Moderatoren e eventit, Bora Bubjaku — studente e vitit të dytë në degën Marketing — e karakterizoi profesionalizmi, energjia dhe aftësia për të komunikuar me publikun. E njohur për pjesëmarrjen e saj aktive në shumë aktivitete studentore, Bora solli në skenë një energji të re, duke e bërë eventin më të gjallë dhe më interaktiv. Ajo lidhi me elegancë çdo pjesë të programit dhe ndihmoi që bisedat të rrjedhin natyrshëm mes folësve dhe audiencës.


Në skenën e TEDxTBU 2025 u ngjiten disa personalitete frymëzuese që ndanë histori të vërteta dhe reflektime mbi fuqinë e inovacionit në jetën profesionale dhe personale.

Alice Taylor, prezantuese televizive dhe autore, foli për ndikimin e teknologjisë dhe komunikimit në shoqërinë moderne, duke theksuar se çdo ndryshim i qëndrueshëm fillon nga mënyra si përcjellim mesazhet tona.

Alban Bala, ekspert i komunikimit, ndau përvojat mbi ndërtimin e markave me ndikim social dhe rëndësinë e etikës në biznes.

Alban Çakalli, fermer dhe inovator, foli për transformimin e bujqësisë tradicionale përmes teknologjisë dhe risive të qëndrueshme.

Erjon Hasanaj, ekspert i sigurisë kibernetike, trajtoi sfidat digjitale dhe mbrojtjen e të dhënave si prioritet të inovacionit.



Arkitekti Gëzim Paçarizi theksoi lidhjen mes hapësirës, krijimtarisë dhe mendimit urban, duke treguar se inovacioni pasqyrohet edhe në mënyrën si ndërtojmë qytetet.

Dr. Alfred Aga, mjek kirurg, foli për balancën mes teknologjisë dhe humanizmit në kujdesin ndaj pacientit, ndërsa eventin u përmbyll me një fjalim frymëzues nga Philip Gilpin Jr., CEO ndërkombëtar, mbi inovacionin si mision që bashkon pasionin me qëllimin.

Përgjatë gjithë eventit, të ftuarit ndërvepruan me audiencën duke u përgjigjur pyetjeve dhe duke ndarë këshilla për mënyrën se si idetë mund të shndërrohen në nisma konkrete. Audiencia, u përfshi aktivisht në diskutime mbi sfidat e sipërmarrjes, përgjegjësinë shoqërore të biznesit dhe mënyrën se si të mendosh ndryshe për të krijuar diçka me ndikim.

Në fund të mbrëmjes, TEDxTBU 2025 u vlerësua si një sukses i plotë — jo vetëm për organizimin dhe përmbajtjen, por edhe për mesazhin që përcolli: se inovacioni është më shumë se një ide e re — është një mënyrë të menduari që kërkon guxim, bashkëpunim dhe vizion.

—Bora Bubjaku

Kompania e muajit: **MANETCI**

Një histori suksesi shqiptare që ndërton të ardhmen

Në botën e ndërtimit dhe zhvillimit urban, pak kompani kanë arritur të lënë një gjurmë kaq të fortë dhe të qëndrueshme sa Mane TCI. E themeluar në vitin 2002, kompania është kthyer në një nga emrat më të besueshëm të industrisë së ndërtimit në Shqipëri dhe rajon. Që në fillimet e saj, filozofia e punës së Mane TCI është mbështetur mbi inovacionin, cilësinë dhe zhvillimin afatgjatë, duke reflektuar vizionin e themeluesit të saj, Samir Mane, një ndër sipërmarrësit më të suksesshëm të Ballkanit.

Që në momentin e krijimit, kompania u dallua për ritmin dhe qasjen e saj moderne ndaj ndërtimit. Në treg u përhap shpejt shprehja: "Ku shkel Samiri ('Mane TCI'), krijohet së shpejti një zonë e re." Kjo nuk ishte thjesht një fjalë goje – ishte realitet. Çdo projekt i ndërmarrë nga kompania sillte zhvillim, punësim dhe vlerë të re për komunitetet lokale.

Sot, Mane TCI ka evoluar në dy entitetet të njohura si Balfin Development dhe Balfin Construction të cilat janë pjesë e Balfin Group, një nga grupet më të mëdha investuese në Evropën Juglindore, që operon në fusha që variojnë nga pasuritë e paluajtshme, tregtia, industria dhe turizmi, deri te energjia dhe shërbimet financiare. Falë këtij integriteti, Mane TCI, por dhe pasardhësit e kësaj firme kanë patur mundësinë të zhvillojë projekte që jo vetëm ndërtojnë struktura, por krijojnë ekosisteme të plota urbane që i japin frymë qyteteve shqiptare.

Falë punës së palodhur dhe vizionit afatgjatë, Mane TCI është bërë sinonim i zhvillimit urban dhe ndërtimit modern në Shqipëri. Kompania njihet për projektet e saj të guximshme dhe konceptet e reja të sjellura në treg, standardet e larta nëpërmjet stafit të kualifikuar dhe konsulencës të specializuar në fushën e ndërtimit e cila ka qënë e personalizuar për secilën nga situatat. Me një filozofi që kombinon inovacionin, estetikën dhe qëndrueshmërinë, Mane TCI ka fituar besimin e tregut dhe respektin e publikut.

Pas çdo ndërtese, pas çdo projekti, qëndron një filozofi e qartë: të ndërtohet diçka që zgjat dhe që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Kjo është arsyeja pse Mane TCI ka fituar reputacionin e një partneri të besueshëm për institucione, investitorë dhe qytetarë.

Sot, më shumë se 20 vite pas themelimit, Mane TCI vazhdon të jetë sinonim i inovacionit dhe cilësisë në ndërtim. Kompania jo vetëm që ndërton godina, por edhe krijon realitete të reja, duke transformuar zona të tëra në qendra moderne tregtare, banimi dhe biznesi. Nën drejtimin vizionar të Samir Manes, filozofia e zhvillimit mbetet e njëjtë: të ndërtohet me pasion, përgjegjësi dhe vizion për të ardhmen.

–Endi Saliko


Studentët e TBU në Epokën e **INTELIGJENCËS ARTIFICIALE**

Epoka e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale (AI) po ndryshon mënyrën se si mësojmë, punojmë dhe komunikojmë. Çdo ditë, mjetet digjitale dhe sistemet inteligjentë na ndihmojnë të marrim vendime më të informuara dhe të zhvillojmë ide të reja. Studentët e Tirana Business University (TBU) nuk mbeten pas. Ata po përgatiten të jenë jo vetëm përdorues të teknologjisë, por edhe krijues të ndryshimit, duke kombinuar kreativitetin me aftësitë digjitale që kërkon tregu global i punës. Në këtë mënyrë, ata po zhvillojnë një perspektivë të re, ku teknologjia dhe mendimi kritik punojnë së bashku.

Në auditorët e TBU-së, AI është bërë një partner i vlefshëm në mësim. Studentët përdorin teknologjinë për kërkime shkencore, analiza tregu, ndërtim strategjish marketingu dhe simulime të modele biznesi, duke nxjerrë mësim praktik nga teoritë akademike. Kjo u jep atyre një avantazh në zhvillimin e aftësive profesionale dhe përgatitjen për sfidat e tregut të punës. Pedagogët e TBU-së i udhëzojnë studentët që AI të përdoret me etikë dhe përgjegjësi, duke forcuar mendimin kritik dhe kreativitetin.



Inteligjenca artificiale është një ndihmës, jo një zëvendësues i aftësive njerëzore si krijimtaria, analiza logjike dhe empatia, aftësi që mbeten thelbësore për suksesin profesional. Studentët e TBU-së gjithashtu mësojnë të shohin më gjerë ndikimin e teknologjisë. AI mund të përdoret për të përmirësuar shërbimet dhe proceset e punës, për të marrë vendime më të mençura dhe për të rritur efikasitetin në fusha të ndryshme. Ata kuptojnë se teknologjia nuk është qëllim në vetvete, por një mjet për të ndërtuar të ardhmen me përgjegjësi dhe inovacion. Tirana Business University është një vend ku arsimi dhe teknologjia bashkohen, duke i mundësuar studentëve të përdorin AI-në për të krijuar ide dhe zgjidhje inovative. E ardhmja nuk është diçka që pritet — është diçka që ndërtohet, dhe studentët e TBU-së po e ndërtojnë atë sot.



Një ditë e zakonshme në jetën e një studenti të TBU

Çdo mëngjes, dera e TBU-së hapet si një portë drejt mundësive të reja. Qindra studentë hyjnë me hapa të shpejtë, me libra në duar dhe ëndrra në zemër. Zërat e tyre mbushin korridoret me energji, entuziazëm dhe shpresë. Disa përshëndesin miqtë e ngushtë, të tjerë lexojnë me nxitim për leksionin e parë. Atmosfera është ajo e zakonshme për një mëngjes universitar – plot jetë, gjallëri dhe pritshmëri.

Ora e parë nis. Auditorët mbushen dhe zërat ulen për t'i lënë vend fokusit. Pedagogët hyjnë me buzëqeshje, gati të nisin një tjetër orë diskutimi, analize e zbulimi. Në një nga klasat e menaxhimit, studentët ndahen në grupe për të zgjidhur një rast studimi real. Në një tjetër, një leksion mbi financat kthehet në debat të hapur mbi vendimet ekonomike në tregun shqiptar. “Në TBU nuk mjafton të mësosh përmendësh,” – thotë një pedagogë. “Duhet të kuptosh si të mendosh si profesionist.” Dhe kjo është ndoshta ajo që e dallon çdo ditë në TBU – mënyra si studentët mësojnë të mendojnë ndryshe, të pyesin më shumë, të kërkojnë më thellë.

Pas orëve të para, kampusi kthehet në qendrën më të gjallë të ditës. Rreshtat për kafe janë një ritual i përditshëm. Në çdo tavolinë dëgjohen tema të ndryshme: një grup diskuton për projektin që duhet dorëzuar javën tjetër; disa studentë të marketingut flasin për idenë e tyre për një startup; të tjerë thjesht qeshin me ndonjë batutë nga ora e fundit. Është një miks perfekt mes punës dhe argëtimit – ajo që i jep ritëm ditës studentore.

Pasdite, ritmi ndryshon, por energjia mbetet. Disa studentë shkojnë në bibliotekë, ku heshtja është pothuajse frymëzuese. Të tjerë ndjekin seminare jashtë orarit, ose punojnë në praktika që i ndihmojnë të prekin realitetin profesional. Në një sallë tjetër zhvillohet një leksion i hapur me një sipërmarrës të suksesshëm – moment ideal për të marrë frymëzim dhe për të parë nga afër rrugët që çojnë drejt suksesit.

Ndërkohë, jeta studentore në TBU nuk përfundon me leksionet. Klubi i debatit po përgatitet për një garë ndëruniversitare; grupi i inovacionit punon për një projekt të ri teknologjik; ndërsa klubi i artit përgatit një ekspozitë mbi jetën në universitet. Këto aktivitete nuk janë thjesht jashtëshkollore – ato janë pjesë e formimit, të një përvoje që i mëson studentët të bashkëpunojnë, të mendojnë krijueshëm dhe të ndërtojnë rrugën e tyre me pasion.

Kur dielli fillon të perëndojë mbi oborrin e universitetit, studentët dalin një nga një, me librat në duar dhe një buzëqeshje të lehtë lodhjeje. Disa nisen drejt shtëpisë, të tjerë ndalen në kafenenë ngjitur për të folur edhe pak më shumë. Në ajër ndihet ajo ndjesi e bukur që sjell çdo ditë e plotësuar: ajo ndjesi që ke mësuar diçka të re, që je bërë pak më i aftë, pak më i sigurt për rrugën që ke zgjedhur.

Në TBU, çdo ditë nuk është thjesht një ditë mësimi – është një hap përpara në rrugën drejt ëndrrave. Është një kapitull i ri në historinë e një brezi që beson se suksesi ndërtohet me pasion, dije dhe këmbëngulje. Dhe çdo mëngjes, kur dera hapet sërish, fillon një tjetër ditë plot mundësi, frymëzim dhe jetë.

–Fioralba Hajdaraj

NGA STUDENTË NË QYTETARË:

Arsimi si Forcë Ndryshimi

Kalimi nga jeta studentore në atë qytetare është një nga periudhat më të rëndësishme dhe sfiduese në jetën e një individi. Nuk është thjesht një ndryshim formal, por është një transformim i thellë në mënyrën se si e percepton veten dhe rolin tënd në shoqëri. Universiteti nuk është vetëm vendi ku përftojmë dije, por mjedisi që na mëson të mendojmë, të ndjejmë dhe të veprojmë me përgjegjësi, duke na kthyer nga studentë që mësojnë, në qytetarë që ndikojnë.

Qytetaria nuk kufizohet vetëm në respektimin e ligjeve apo në detyrimet formale. Të qenit qytetar do të thotë të marrësh pjesë në jetën shoqërore, të kuptosh problemet që hasin familjet e thjeshta dhe të përdorësh dijen e fituar nga arsimimi për të ofruar zgjidhje. Universiteti është një hapësirë ku ndeshesh me sfida që forcojnë mendimin kritik dhe aftësitë sociale. Për shembull, detyrat e kursit, diskutimet në klasë dhe puna në grup nuk janë thjesht pjesë e programit akademik. Ato na mësojnë të bashkëpunojmë, të dëgjojmë perspektiva të ndryshme dhe të marrim vendime të mirëvenduara.

Si studente e degës Informatikë Ekonomike, kam mësuar të analizoj tregjet dhe të kuptoj mekanizmat e ekonomisë. Por ajo që më ka lënë gjurmë më të thellë është që si qytetare kam arritur të kuptoj ndikimin që kanë vendimet ekonomike mbi popullsinë dhe shtetin. Diploma nuk përfaqëson fundin e jetës studentore. Ajo është pikënisja e përgjegjësisë të reja. Një i diplomuar nuk është thjesht profesionist në fushën e tij por është një qytetar i aftë të propozojë ide, të ofrojë zgjidhje dhe të kontribuojë për të mirën e përbashkët. Universiteti, përmes eksperiencave që ofron, transformon individin dhe e bën më të ndërgjegjshëm për rolin e tij në shoqëri.

Arsimi mbetet forca që kthen studentët në qytetarë të ndërgjegjshëm dhe të gatshëm për të ndërtuar një të ardhme më të mirë. Të qenit student nuk është fundi, por fillimi i një udhëtimi që kërkon angazhim, përgjegjësi dhe dëshirë për të bërë ndryshim.

– Lea Licanj



Diplomimi 2025

Në mbrëmjen e datës 05/11/2025, në Tiranë, u zhvillua ceremonia solemne e diplomimit të tre brezave të fundit të studentëve të Tirana Business University, të cikleve Bachelor dhe Master. Ishte një mbrëmje plot emocion, ku studentët e Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë, nga profile të ndryshme, hodhën kapelet duke shënuar kulmin e rrugëtimit të tyre akademik.



Në një atmosferë të ngrohtë e festive, të mbushur me duartrokitje, kujtime e buzëqeshje, të pranishëm ishin personalitete të botës akademike dhe të biznesit, të cilët ndanë fjalë frymëzuese për të diplomuarit.



Ceremonia u çel me fjalën përshëndetëse të Rektores së TBU, Prof. Dr. Vasilika Kume, e cila theksoi rëndësinë e dijes, përkushtimit dhe integritetit si shtylla të suksesit profesional. Më pas, themeluesi i TBU, Prof. Artan Hoxha, ndau mesazhe motivuese mbi rëndësinë e vazhdimësisë në mësim dhe ndikimin pozitiv që universiteti ka pasur në formimin e brezave të rinj.

Ceremoninë e përshëndeti edhe Drejtoresha Ekzekutive e Grupit BALFIN, znj. Edlira Muka, e cila vuri në dukje lidhjen e veçantë që TBU ka krijuar ndër vite mes dijes akademike dhe praktikës profesionale, si dhe mundësitë që studentët kanë për zhvillim brenda kompanive të Grupit BALFIN.



Eventi nisi me betimin e studentëve të rinj të vitit të parë, të cilët filluan zyrtarisht rrugëtimin e tyre në TBU, ndërsa ish-studentë të suksesshëm ndanë përvojat e tyre pas diplomimit, duke treguar sesi studimet në TBU i kanë ndihmuar të arrijnë qëllimet profesionale.



Mbrëmja u kthye në një kujtim të paharrueshëm për qindra studentë, familjarë dhe miq, të cilët festuan bashkë me krenari arritjet dhe sfidat e përbashkëta të viteve universitare.

Në përfundim, TBU përcolli një mesazh të qartë për të gjithë të diplomuarit:

“Suksese në çdo hap të rrugëtimit tuaj! Tirana Business University do të jetë gjithmonë këtu për ju.”

ÇMIMET NOBEL 2025

Në vitin 2025, Nobel Foundation shpalli laureatët në gjashtë kategori kryesore: Fizikë, Kimia, Mjekësi, Letërsi, Paqe dhe Ekonomi. Çmimet e këtij viti tregojnë se përparimi i njerëzimit vjen nga kurioziteti, kreativiteti dhe përkushtimi për dije, art dhe drejtësi. Secili fitues na tregon se ndikimi i shkencës dhe kulturës është i madh për jetën e përditshme.

Fizikë

John Clarke, Michel H. Devoret dhe John M. Martinis u nderuan për zbulimin e tunelimit kuantik makroskopik dhe matjen e energjisë në qarqe elektrike. Ky hulumtim tregon se fenomenet kuantike mund të ndodhin edhe në sisteme më të mëdha. Rezultatet e tyre hapin rrugë për zhvillimin e teknologjive kuantike në të ardhmen.

Kimia

Susumu Kitagawa, Richard Robson dhe Omar M. Yaghi zhvilluan kornizat metal-organike (MOF). Këto materiale kanë hapësira të mëdha që mund të përdoren për kapjen e CO₂-së dhe ruajtjen e gazrave. Përdorimet e tyre praktike përfshijnë mbledhjen e ujit nga ajri dhe katalizën e reaksioneve kimike.

Fiziologji / Mjekësi

Mary E. Brunkow, Fred Ramsdell dhe Shimon Sakaguchi zbuluan rolin e qelizave T rregullatore në tolerancën imune. Ky zbulim ndihmon të kuptohet si sistemi imunitar mbron trupin nga sulmet ndaj qelizave të veta. Ai hap rrugë për trajtime të reja kundër sëmundjeve autoimune dhe disa kancereve.

Letërsi

László Krasznahorkai u nderua për prozën e tij filozofike dhe vizionare. Veprat e tij trajtojnë kaosin, vetminë dhe sfidat e shoqërisë moderne. Ai ripohon fuqinë e artit për të reflektuar dhe për të sfiduar realitetin.

Paqe

María Corina Machado u shpall fituese për përpjekjet e saj në mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave civile në Venezuelë. Ajo ka luftuar për një tranzicion paqësor nga diktatura në demokraci. Çmimi i saj simbolizon rëndësinë e guximit qytetar dhe të drejtave njerëzore.

Ekonomi

Joel Mokyr, Philippe Aghion dhe Peter Howitt studiuuan rritjen ekonomike të qëndrueshme përmes inovacionit dhe "shkatërrimit krijues". Ata tregojnë se teknologjia dhe inovacioni janë motorët kryesorë të zhvillimit ekonomik. Ky studim ndihmon të kuptohet sesi institucionet dhe tregjet ndikojnë në progresin afatgjatë.

Çmimet Nobel 2025 na kujtojnë se shkencë, arti dhe veprimi qytetar janë shtyllat e një bote më të drejtë dhe më të zhvilluar. Çdo fitues tregon se njohuria dhe përkushtimi mund të ndryshojnë botën.

–Albian Ullorja

TAYLOR SWIFT: Kur arti bëhet strategji

Një histori e suksesshme e lidërshipt, marketingut dhe menaxhimit të imazhit në epokën moderne të muzikës.

Suksesi i jashtëzakonshëm i Taylor Swift nuk është rastësi. Ai është rezultat i një kombinimi të rrallë mes talentit artistik dhe strategjisë së menaxhuar me inteligjencë.

Në një industri ku fama është shpesh e përkohshme, Swift ka ndërtuar një markë personale që i reziston kohës – duke treguar se arti dhe biznesi mund të ecin paralelisht kur udhëhiqen nga vizioni dhe vlerat.

Kontrolli mbi pronësinë dhe produktin

Një nga momentet më të rëndësishme në karrierën e saj ishte vendimi për të reregjistruar albumet ("Taylor's Version"), pasi humbi të drejtat mbi master recordings.

Ky hap i guximshëm e shndërroi në simbol të autonomisë artistike dhe fuqisë së grave në industri, duke dhënë një mësim universal: suksesi fillon kur kontrollon produktin tënd.

Autenticiteti si strategji marketingu

Taylor nuk shet thjesht muzikë – ajo ndan rrëfime personale që prekin audiencën.

Përmes teksteve të ndershme dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me fansat, ajo ka ndërtuar një komunitet emocional, jo vetëm një bazë dëgjuesish.

Në një botë të mbingarkuar me imazhe artificiale, autenticiteti është valuta e re e besueshmërisë.

Diversifikimi dhe menaxhimi strategjik

Swift ka transformuar karrierën në një ekosistem të integruar biznesi – që përfshin turne globale, dokumentarë, filma, bashkëpunime kreative dhe nisma filantropike.

Ajo është një shembull i sipërmarrjes moderne, ku arti, komunikimi dhe ekonomia bashkohen në një strategji unike ndikimi.

Rebranding i vazhdueshëm

Nga vajza e country në ikonën e pop-it global, Taylor Swift ka treguar një aftësi të jashtëzakonshme për t'u përshtatur, duke ruajtur njëkohësisht thelbin e identitetit të saj artistik.

Kjo elasticitetë e qëllimshme është sekreti i suksesit në çdo industri – të dish të ndryshosh pa humbur thelbin.

"Taylor Swift është simbol i një lidërshipi të ri – ku pasioni, etika dhe strategjia bashkohen për të krijuar vlerë të qëndrueshme."

– Fiola Perisnaka



Numri i dytë i gazetës studentore të Tirana Business University, Tetor 2025. ©

Adresa: Rruga Rezervat e Shtetit, Lundër, Tiranë, Shqipëri

Cel: +355 697066966

Tel: +355 42260443

Email: info@tbu.edu.al

